



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KESHILLI I BASHKISË



VENDIM

NR 62 Datë 30.12.2016

PËR

**MARRJEN E NISMËS PËR HARTIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË
BASHKISË VAU DEJES**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, neni 64/a, të Ligjit 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, neni 5, pika 1.3/b dhe neni 13 pika 1/b, të VKM 671, datë 29.07.2015 “Rregullore e Planifikimit të Territorit”, neni 58, pika 1/a, të nenit 128, të Ligjit 8485, datë 12.05.1999 “Kodi I procedurave Administrative”, i ndryshuar

VENDOSI

1. Marrjen e nismës për hartimin e Planit të Përgjithëm Vendor të Bashkisë Vau Dejes.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është Dokumenti I Nismës Për Hartimin e Planit të Përgjithëm Vendor të Bashkisë Vau Dejes .
3. Per zbatimin e ketij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të ligjit 139/2015 Për Veteqeverisjen Vendore, neni 55 pika 6.
5. Ky vendim u shpall me datë 09.01.2017

Sekretar i Këshillit

Gentian NDOJ



Kryetar i Këshillit

Martin MARKU